

VENDIM
Nr. 199, datë 10.4.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE,
PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT**

(Ndryshuar me vendimin nr. 77, datë 10.2.2021; nr. 143, datë 11.3.2022; nr. 585, datë 7.9.2022; nr. 642, datë 22.11.2023 ; nr. 57, datë 7.2.2024; nr. 174, datë 20.3.2025; nr. 550, datë 1.10.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e zëvendëskryeministrit, *zgj. Belinda Balluku*, kryetar të këshillit drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

2. Emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si më poshtë vijon:

- *Z. Blendi Gonxhja, ministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit;*
- *Z. Andis Salla, ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;*
- *Z. Ervin Demo, ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor;*
- *Zgj. Ana Kapaj, zëvendësministër i Arsimit.*

3. Vendimi nr. 982, datë 25.10.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe